

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DIMAL
TITULLAR I AUTORITETIT KONTRAKTOR

Nr. _____ prot.

Urë Vajgurore, më ____ . ____ . 2025

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - MALLRA

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

Objekti i prokurimit: “Blerje materiale për mirëmbajtjen e objekteve dhe veprave të artit”

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT : (FPP) 44,
44100000-1, 44111100-2, 44111200-3, 44114200-4, 44163100-1, 44334000-0, 44810000-1**

Fondi limit: 2 083 333 (dy milion e tetëdhjetë e tre mijë e treqind e tridhjetë e tre) lekë pa TVSH.

Argumentimi:Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar me VKM-në nr.714, datë 24.11.2021 autoriteti/enti kontraktor Bashkia Dimal ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës9;*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës4;*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, dhe nenin 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Sipas percaktimeve të vendosura në Kriteret e Pergjithshme të Kualifikimit dhe të vecanta të kualifikimit (Shtojcat).

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë pasqyrat financiare vjetore (bilancet e viteve, tre viteve të fundit 2022,2023,2024, të çertifikuara nga organet tatimore. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e percaktimeve të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me akt-ekspertizën e ekspertit kontabël të autorizuar. Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga secili anëtar i bashkimit

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është percaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP; të nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” si dhe të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe kontabilistit të miratuar”.

Percaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, në Ligjin nr. 9920 datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, dhe aktet nenligjore në zbatim të tij.

2.2.2.Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për 3 (tre) vitet e fundit financiare nga data e zhvillimit të tenderit, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40 % të vlerës së përlogaritur të kontratës.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është percaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, të LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Percaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Vlera e kërkuar është në përpjestim të drejtë me fondin limit të procedurës.

Kërkesat e mësipërme i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjëndjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës.

2.2.3 Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të ketë shlyer taksat për vitin 2024 për adresën ku ai ushtron aktivitet sipas Ekstraktit Historik lëshuar nga QKR, ku të përfshihet kësti për periudhën përkatëse të maturuar, sipas përcaktimeve të ligjit nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, ku nëse kualifikohet, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, duhet të paraqesë vërtetim/e lëshuar nga Bashkia me anë të së cilit të vërtetohet shlyerja e këtyre taksave sipas vetëdeklarimit të kryer në shtojcën 8 të DST-së.

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga secili anëtar i bashkimit.

Argumentim:Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” e ndryshuar dhe në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore”, i ndryshuar, në ligjin nr.9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore”, i ndryshuar, neni 4, pika 2 d).

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë se ka paguar detyrimet e taksave vendore për vitin 2024, bazuar në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 si dhe vendimeve respektive të Këshillave Bashkiakë në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit të DST-së objekt prokurimi.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20 % të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate,

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës.
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruar në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.
- c) **Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë **jo** më të vogël, se 20% e vlerës së fondit limit të lotit.

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit, në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

2.3.2 Vertetim per numrin mesatar te punonjesve per periudhen kohore 3 (tre) muajt e fundit te deklaruar, jo me i vogel se 3 punonjes, i vertetuar nga organet tatimore per te mundesuar realizimin e kontrates me sukses.

Ne lidhje me kete pike te paraqitet: Vertetim nga administrata tatimore per numrin e punonjesve te siguruar si dhe listepagesat per secilin muaj.

Disponimi i punonjesve si me siper do të deklarohet në seksionin përkatës të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit sipas shtojcës 9 në DST, si dhe në rast se kualifikohet, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, duhet të paraqesë dokumentacionin e kërkuar më lart.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2.33. Operatori ekonomik ofertues te paraqese certifikatat qe verteton se sistemi i kontrollit te cilesise se ofertuesit është sipas standartit.

Ofertuesit duhet te paraqesin Certificate ISO 9001:2015, te standartit nderkombetar te menaxhimit te cilesise dhe/ ose te njevlefshme, te cilat do te garantonin cilesine e produktit ose standart ISO me e avancuar e perkthyer e noterizuar. Certifikata duhet te jete e vlefshme dhe e leshuar nga organizmat e vleresimit te konformitetit, te cilet jane akredituar nga DAP ose nga organizmat nderkombetar akreditues te njohur nga Republika e Shqiperise.

Argumentimi: Kërkesa e cilësisë të përcaktuara sipas pikës 3.1, është vendosur në mbështetje të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 79, pika 1 ku citohet se: “Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë”, si dhe ne zbatim të Neni 44, pika 1 dhe pika 3 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ku përcaktohet se: “Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit”.

ISO 9001:2015 është një seri normash dhe standartizimesh ndërkombëtare, qe i referohen sistemeve të menaxhimit të cilësisë, pra, të strukturave të organizimit të ndërmarrjeve publike dhe

private, struktura të cilat këto ndërrmarje duhet t'i adoptojnë për një orientim më të mirë të ndërrmarjes në standartet e tregut. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 9001:2015 me qëllim efektivitetin dhe efektshmërinë në zhvillimin e veprimtarisë së tij, e cila do të sjellë dhe zvogëlimin e kostove. Pra ky certifikim do të bëjë të mundur që Ofertuesit të ofrojnë cilësi të mirë të mallve me çmime të ulta.

2.3.4. Operatori ekonomik ofertues duhet te garantoje kapacitetin transportues te mallrave si me poshte:

1-Operatori ekonomik ofertues duhet te disponoje nje automjet te pershtatshem per transportit e mallrave objekt prokurimi, i cili duhet te jete i disponueshem per te furnizuar mallin **aty ku do te dorezohet malli objekt prokurimi, per te cilin duhet te paraqese dokumentat e meposhtme:**

2-Aktin e pronesise se mjetit perkates ose Kontraten e marrjes me qirat e mjetit, shoqeruar me dokumentacionin perkates te pronesise se mjetit qe ka pronari, i cili e jep me qera. Kontrata e qirase te jete noteriale.

3-Per mjetet qe shenohen ne regjistrat publike (qofte ne pronesi apo dhe me qira) duhet te paraqitet dokumenti qe verteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), certifikate e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit, taksat vjetore si dhe lejen e transportit per vete ose te trete per atomjete qe pajisen me leje transporti sipas legjislacionit ne fuqi.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion mjetet e nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit. Pra mjeti i kërkuar do të jetë i nevojshëm për kryerjen e transportit të materialeve të ndërtimit .

2.3.5 Deklarate nga Operatori Ekonomik qe merr persiper transportin e mallrave objekt prokurimi, ne cdo kohe dhe vendndodhje te territorit administrative te Bashkise Dimal dhe sipas kerkesave te AK ne sasine dhe cilesine e kerkuar.

Argumentimi: Me anë të kësaj deklarate synohet OE do te jete i gatshem të kryeje dorëzimin e mallit sipas nevojës Autoritetit Kontraktor në kohë dhe pa problematika.

2.3.6 Operatori ekonomik ofertues duhet te paraqese flete-analize per artikujt:

“Çimento” nga nje laborator i akredituar ne Republiken e Shqiperise dhe ose nga subjekti furnizues i tij, ose prodhues i mallit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenit 40, pika 6, gërma c,) dhe neni 44 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Ky kriter kerkohet per te patur garancine se malli qe do te dorezohet prane magazines se sektorit funeral te jete brenda standarteve te kerkuara.

2.3.7. Operatori ekonomik ofertues ne rast se nuk eshte prodhues per artikujt e lartepermendur, te paraqese Autorizim nga Prodhuesi, ose distributor i autorizuar, i cili merr persiper te furnizojë Ofertuesin me artikujt objekt prokurimi. Ne rastin e distributorit te autorizuar te paraqitet edhe dokumenti qe verteton lidhjen e distributorit te autorizuar me firmen prodhuese. (Autorizimi te jete i perkthyer dhe i noterizuar, nese nuk eshte ne gjuhen shqipe).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenit 40, pika 6, gërma c,) dhe neni 44 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Ky kriter kerkohet per te patur garanci se OE pjesemarres eshte i autorizuar nga prodhuesi per tregtimin e mallrave objekt prokurimi i cili ka marre persiper furnizimin e tij. Ky kriter kerkohet per te garantuar disponibilitetin e mallit objekt prokurimi nga OE pjesemarres ne cdo moment qe do te kerkohet furnizim nga AK.

Pra nëpërmjet vendosjes së kriterit të sipërpërmendur AK garantohet dhe fiton siguri se operatori ekonomik kontraktues do të furnizojë dhe do të përmbushë kontratën me sukses

Argumentimi i specifikimeve teknike:

I. Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet teknike janë vendosur në bazë të kërkesës për blerje matetrialet ndertimi të Drejtorisë së Shërbimit Publik, dhe dokumentacionit bashkelidhur saj, si dhe ne perputhje me Ligjin nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 4, pika 38/b: *“Specifikime teknike” janë: b) në rast të prokurimit public të mallrave ose shërbimeve,specifikimi me të cilin përkufizohen karakteristikat e prodhimit ose shërbimit, siç janë niveli i cilësisë, ndikimi mbi mjedisin jetësor dhe ndikimet klimatike, përshkrimi të gjitha kushteve, duke përfshirë edhe arritshmëri për persona me aftësi të kufizuar dhe vlerësim të përputhshmërisë, niveli i realizimit, shfrytëzimi prodhimit, siguri ose dimensione, duke i përfshirë edhe kërkesat relevante për produktin në raport me emërtimin me të cilin shitet, terminologjinë, simbolet, testimet dhe metodat për testim, paketimin, shënimin dhe etiketimin, si dhe udhëzime për përdorim, proceset dhe metodat e prodhimit në secilën fazë të jetëgjatësisë së mallrave dhe shërbimeve, si dhe procedura për vlerësim të përputhshmërisë, nenin 36 të ligjit nr.162/2020, “Per Prokurimin Publik”, nenin 40, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar: *Për mallrat që do të prokurohen, autoritetet/entetkontraktore parashikojnë specifikimet teknike, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të**

rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, në përputhje me nenin 36, të LPP-së, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara.

Specifikimet teknike janë hartuar nga grupi i punës i ngritur me urdher të titullarit të autoritetit kontraktor, bashkëngjitur DST në SPE. Kriteret e vecanta të kualifikimit janë hartuar nga specialisti i fushës pjese e njesise se prokurimit.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.